



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:061276

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06578574

KPPP.nr.598/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen përmbartimore të kreditorit NPT "Frutti" me NUI 810593336 dhe seli Reqan në Prizren, kundër debitorit "The North Unicorn" me NUI 810112186 dhe seli në Zonën Industriale në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor, jashtë seancës me datë 29 nëntor 2024, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit "The North Unicorn" me NUI 810112186, i ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.136/2023 të datës 22.03.2023 të përmbartuesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren.
- II. Mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.136/2023 i datës 22.03.2023 i përmbartuesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta lidhur me këtë procedurë në gjykatë, sipas prapësimit të debitorëve të përmbartimit.

ARSYETIM

Kreditori më 22.03.2023 ka parashtruar propozim për përmbartim (këtu e tutje Propozimi) në zyrën e përmbartuesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren (këtu e tutje Përmbartuesi), me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori që t'ia paguaj shumën prej 37,617.82€ me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim e kishte bazuar në fatura nr.22/3231 PR e datës 23.08.2022, 22/1942 PZ e datës 25.08.2022, 22/1943 PZ 25.08.2022, 22/1944 PZ e datës 25.08.2022, 22/1945 PZ e datës 25.08.2022, 22/1946 PZ e datës 25.08.2022, kompensimi i datës 26.08.2022, 22/3400 PR e datës 26.08.2022, 22/3401 PR e datës 31.08.2022, 22/3403 PR e datës 31.08.2022, 22/3404 PR e datës 31.08.2022, 22/3405 PR e datës 31.08.2022, 22/3406 PR e datës 31/08.2022, 22/3407 PR e datës 31.08.2022, 22/3408 PR e datës 31.08.2022, 22/3409 PR e datës 31.08.2022, 22/3410 PR e datës 31.08.2022, 22/3419 PR e datës 31.08.2022,

22/3420 PR e datës 31.08.2022, HIN 597 e datës 31.08.2022, 22/2038 PZ e datës 31.08.2022, 22/2039 PZ e datës 01.09.2022, 22/2040 PZ e datës 01.09.2022, 22/2041 PZ e datës 01.09.2022, 22/2042 PZ e datës 01.09.2022, 22/2043 PZ e datës 01.09.2022, 22/2044 PZ e datës 01.09.2022, 22/2045 PZ e datës 01.09.2022, 22/2046 PZ e datës 01.09.2022, 22/2047 PZ e datës 01.09.2022, 22/0536 Pejë e datës 01.09.2022, 22/0537 Pejë e datës 01.09.2022, 22/0538 Pejë e datës 01.09.2022, 22/0539 Pejë e datës 01.09.2022, 22/2129 PZ e datës 01.09.2022, 22/2132 PZ e datës 02.09.2022, 22/2133 PZ e datës 15.09.2022, 22/2134 PZ e datës 15.09.2022, 22/2130 PZ e datës 15.09.2022, 22/2152 PZ e datës 15.09.2022, 22/2151 PZ e datës 15.09.2022, 22/2150 PZ e datës 16.09.2022, 22/3672 PR e datës 16.09.2022, 22/3673 PR e datës 16.09.2022, 22/3674 PR e datës 16.09.2022, 22/3675 PR e datës 19.09.2022, 22/3676 PR e datës 19.09.2022, 22/3677 PR e datës 19.09.2022, 22/3678 PR e datës 19.09.2022, 22/3679 PR e datës 19.09.2022, 22/3680 PR e datës 19.09.2022, 22/3681 PR e datës 19.09.2022, 22/3682 PR e datës 19.09.2022, 22/3683 PR e datës 19.09.2022, 22/0559 Pejë e datës 19.09.2022, 22/0560 Pejë e datës 19.09.2022, 22/0561 Pejë e datës 19.09.2022, 22/0562 Pejë e datës 19.09.2022, 22/2172 PZ e datës 19.09.2022, 22/2173 PZ e datës 20.09.2022, 22/2174 PZ e datës 20.09.2022, 22/2175 PZ e datës 20.09.2022, 22/2176 PZ e datës 20.09.2022, 22/2177 PZ e datës 20.09.2022, 22/2178 PZ e datës 20.09.2022, 22/2179 PZ e datës 20.09.2022, 22/2180 PZ e datës 20.09.2022, 22/2181 PZ e datës 20.09.2022, 22/2181 PZ e datës 20.09.2022, 22/22/3778 PR e datës 20.09.2022, 22/3817 PR e datës 20.09.2022, 22/3941 PR e datës 20.09.2021, 22/4014 PR e datës 27.09.2022, 22/4027 PR e datës 29.09.2022, 22/4033 PR e datës 30.09.2022, 22/4037 PR e datës 06.10.2022, 22/4081 PR e datës 13.10.2022, 22/2377 PZ e datës 15.10.2022, 22/4925 PR e datës 15.10.2022, 22/4930 PR e datës 17.10.2022, 22/4963 PR e datës 18.10.2022, 22/2756 PZ e datës 19.10.2022, 22/2757 PZ e datës 19.10.2022, 22/2758 PZ e datës 19.10.2022, 22/2759 PZ e datës 19.10.2022, 22/2760 PZ e datës 19.10.2022, 22/2761 PZ e datës 19.10.2022, 22/2762 PZ e datës 19.10.2022, 22/2763 PZ e datës 20.10.2022, 22/2764 PZ e datës 20.10.2022, 22/4983 PR e datës 20.10.2022, 22/4984 PR e datës 20.10.2022, 22/4986 PR e datës 20.10.2022, 22/4987 PR e datës 20.10.2022, 22/4988 PR e datës 20.10.2022, 22/4985 PR e datës 20.10.2022, 22/0696 Pejë e datës 20.10.2022, 22/0697 Pejë e datës 20.10.2022, 22/0698 Pejë e datës 20.10.2022, 22/0699 Pejë e datës 20.10.2022, 22/5126 PR e datës 20.10.2022, 22/5141 PR e datës 20.10.2022, 22/5202 PR e datës 20.10.2022, 22/5241 PR e datës 21.10.2022, 22/2939 PZ e datës 21.10.2022, 22/2940 PZ e datës 21.10.2022, 23/226 PZ e datës 21.10.2022, 23/39 PZ e datës 31.10.2022, 23/40 PZ e datës 02.11.2022, 23/67 PR e datës 02.11.2022, 23/113 PR e datës 02.11.2022, 23/93 PZ e datës 09.11.2022, 23/94 PZ e datës 11.11.2022, 23/995 PZ e datës 11.11.2022, 23/96 PZ e datës 15.11.2022, 23/134 PZ e datës 15.11.2022, 0031 Pejë e datës 18.11.2022, 23/182 PZ e datës 18.11.2022, 23/446 PR e datës

22.11.2022, 23/452 e datës 22.11.2022, 23/542 e datës 22.11.2022, 22/3231 PR e datës 22.11.2022, 22/1942 PZ e datës 25.11.2022, 22/1943 PZ e datës 25.11.2022, 22/1944 PZ e datës 25.11.2022, 22/1945 PZ e datës 26.11.2022, 22/1946 PZ e datës 26.11.2022, kompensim datës 30.11.2022, 22/3400 PR e datës 30.11.2022, 22/3401 PR e datës 30.11.2022, 22/3403 PR e datës 30.11.2023, 22/3404 PR e datës 30.11.2022, 22/3405 PR e datës 30.11.2022, 22/3406 PR e datës 01.12.2022, 22/3407 PR e datës 02.12.2022, 22/3408 PR e datës 02.12.2022, 22/3409 PR e datës 02.12.2022, 22/3410 PR e datës 02.12.2022, 22/3419 PR e datës 12.02.2022, 22/3420 PR e datës 02.12.2022, HIN 597 e datës 05.12.2022, 22/2038 PZ e datës 06.12.2022, 22/2039 PZ e datës 06.12.2022, 22/2040 PZ e datës 06.12.2022, 22/2041 PZ e datës 06.12.2022, 22/2042 PZ e datës 06.12.2022, 22/2043 PZ e datës 07.12.2022, 22/22/2044 PZ e datës 07.12.2022, 22/2045 PZ e datës 07.12.2022, 22/2046 PZ e datës 07.12.2022, 22/2047 PZ e datës 07.12.2022, 22/0536 Pejë e datës 07.12.2022, 22/0537 Pejë e datës 07.12.2022, 22/0538 Pejë e datës 08.12.2022, 22/0539 Pejë e datës 08.12.2022, 22/2129 PZ e datës 08.12.2022, 22/2132 PZ e datës 08.12.2022, 22/2133 PZ e datës 08.12.2022, 22/2134 PZ e datës 08.12.2022, 22/2130 PZ e datës 08.12.2022, 22/2152 PZ e datës 08.12.2022, 22/2151 PZ e datës 08.12.2022, 22/2150 PZ e datës 08.12.2022, 22/3672 PR e datës 08.12.2022, 22/3673 PR e datës 08.12.2022, 22/3637 PR e datës 08.12.2022, 22/3674 PR e datës 08.12.2022, 22/3675 PR e datës 08.12.2022, 22/3676 PR e datës 08.12.2022, 22/3677 PR e datës 08.12.2022, 22/3678 PR e datës 08.12.2022, 22/3679 PR e datës 08.12.2022, 22/3680 PR e datës 08.12.2022, 22/3681 PR e datës 09.12.2022, 22/3682 PR e datës 17.12.2022, 22/3683 PR e datës 17.12.2022, 22/0560 Pejë e datës 22.12.2022, 22/0561 Pejë e datës 27.12.2022, 22/0561 Pejë e datës 27.12.2022, 22/0562 Pejë e datës 27.12.2022, 22/2172 PZ e datës 31.12.2022, 22/2173 PZ e datës 06.01.2023, 22/2174 PZ e datës 10.01.2023, 22/2175 PZ 10.01.2023, 22/2176 PZ e datës 10.01.2022, 22/2177 PZ e datës 14.01.2023, 22/2178 PZ e datës 17.01.2023, 22/2179 PZ e datës 17.01.2023, 22/2180 PZ e datës 17.01.2023, 22/2181 PZ e datës 17.01.2023, 22/3778 PR e datës 24.01.2023, 22/3817 PR e datës 30.01.2023, 22/3941 PR e datës 01.02.2023, 22/4014 PR e datës 03.02.2023, 22/4027 PR e datës 03.02.2023, 22/4033 PR e datës 08.02.2023 dhe 22/4037 PR e datës 15.05.2023 të tij për Debitorin, të cilën në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Përveç kësaj, Kreditori Propozimit ia ka bashkëngjitur edhe raportin e detajuar të transaksioneve.

Përmbaruesi më 22.03.2023 e ka nxjerrë urdhrin përmbarimor P.nr.136/2023 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbarimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri).

Debitori më 05.04.2023 ka parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta shfuqizoj atë. Ai ka deklaruar se është pronari i

rrjetit të maketeve Deppo Market dhe me Krediton ka pasur marrëveshje furnizim me produkte të pijes. Shton se Kreditori ka paraqitur si fatura të cilat nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar nga ana e Debitorit dhe e as vulën e tij, me çka ndër të tjera cenon rëndë kredibilitetin dhe bazën ligjore të këtij Urdhri. Tutje thekson se faturat e pranuar dhe për borxhin e njoftuar në mënyrë të rregullt, Debitori në vazhdimësi ka realizuar pagesa, siç dëshmohet nga transaksionet bankare datë 16.09.2022 në vlerë prej 6,497.11€, datë 29.09.2022 në vlerë prej 3,764.67€, datë 31.10.2022 në vlerë prej 3,764.67€, datë 07.12.2022 në vlerë prej 3,764.67€, datë 06.01.2023 në vlerë prej 3,764.67€ pra kishte kryer pagesa në vlerë totale prej 21,555.70€, e që në fakt flet qartë për seriozitetin dhe vullnetin e mirë të Debitorit, për të përmbushur obligimet e tij ndaj Kreditorit. Prapësimit ia ka bashkëngjitur dëftesa pagese, certifikatën e biznesit bashkë me informatën mbi biznesin dhe kartelë financiare, ndërsa dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale për paraqitjen e Prapësimit.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar. Ai ka deklaruar se në rastin konkret faturat janë të nënshkruara nga palët dhe në origjinal janë dorëzuar tek përmbaruesi. Ka theksuar se sa i përket disa pagesës të kryera kjo është e vërtetë por Debitori i ka bashkëngjitur disa obligimet të cilat nuk janë të përfshirë në asnjë prej faturave të cilat janë bashkëngjitur propozimit për përmbarim. Shton se me provat e bashkëngjitur prapësimit nga ana e Debitori vetë se është ndihmuar në vërtetimin e gjendjes faktike që debitori ka borxh Kreditorit shumë si në propozim për përmbarim. Përgjigjes në prapësim nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, ndërsa e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale për paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të Debitorëve të paraqitura në Prapësim dhe deklarimeve të Kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se prapësimi është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Kreditori i kishte lëshuar Debitorit fatura lëndore në emër të furnizimit me mall në shumë totale prej 37,617.82 €, të cila janë dorëzuara në origjinal së bashku me Propozimin. Ato përmbajnë të dhëna për Kreditorin dhe Debitorin, numrin e faturës, datën e faturimit, objektin, llojin dhe shumën, si dhe kohën e përmbushjes së detyrimit monetar.

Faturat rezultojnë të nënshkruara dhe të vulosura nga Debitori, meqenëse në ato gjendet vula dhe nënshkrimi i tij. Në shkresat e lëndës nuk ka prova se Debitori i ka kundërshtuar faturat lëndore pas pranimit të tyre në ndonjë aspekt.

Nga shkresat e lëndës nuk rrjedh se Debitori e ka paguar ndonjë nga faturat lëndore qoftë tërësisht ose pjesërisht, ose që kërkesa e Kreditorit, e cila rrjedh nga faturat lëndore, është shuara në ndonjë mënyrë të paraparë në mënyrë ligjore.

Situata e lartcekur rregullohet në rend të parë me nenin me nenin 29 të LPP-së, i cili në para. 1 nënpara. 3 ka rregulluar se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është (...) 1.3 faturat”* ndërsa në para. 3 ka paraparë se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Nga këto dispozita rrjedhë se, përmbartimi mund të fillohet edhe në bazë të faturës si dokument i besueshëm dhe se për të qenë i përshtatshëm për përmbartim dokumenti i besueshëm, ai duhet ta ketë përmbajtjen e kërkuar ligjore. Në rastin konkret, faturat lëndore i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara me nenin e cituar më lartë, rrjedhimisht janë të përshtatshme për përmbartim.

Përveç kësaj, gjykata konstaton se faturat në bazë të cilës është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, edhe për faktin se janë pranuar nga Debitori, ndërsa nuk janë kundërshtuar asnjëherë në ndonjë aspekt nga ai.

Prandaj gjykata e gjeti se faturat lëndore i plotësojnë të gjitha kushtet që në bazë të tyre të caktohet përmbartimi, rrjedhimisht e refuzoi Prapësimin.

Gjykata i gjen si të pabazuar pretendimet e Debitorit rreth përmbushjes së obligimeve nga ana tij, të njëjtat janë të pabazuara, për shkak në dëftesë pagesat e paraqitura nga debitori nuk specifikohet pagesa e obligimit se cila faturë është përmbushur, ndërkaq i ka konsideruar jo relevante provat me të cilat vërtetohet se debitori është duke përmbushur obligime në vazhdimësi.

Përveç kësaj, nuk ka asnjë një provë se Debitori i ka kundërshtuar faturat lëndore lidhur me shumën e tyre. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se Debitori e ka barrën e provës për t'i provuar pretendimet e tij në prapësim, siç e obligon neni 69 para. 4 i LPP-së, i cili shprehimisht ka paraparë se *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.”*

Gjykata i mori parasysh edhe pretendimet tjera si të Kreditorit ashtu edhe Debitorit, megjithatë ato nuk kishin rëndësi për të vendosur ndryshe.

Kjo gjykatë gjithashtu e bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së Propozimit dhe Urdhrit dhe gjeti se ata janë hartuar sipas kërkesave ligjore të LPP-së, ashtu që i përmbajnë të dhënat për palët, për dokumentin e besueshëm, objektin dhe mjetet e përbarimit, si dhe janë caktuar kufijtë e përbarimit, siç rregullojnë nenet 36 para. 1, 38 para. 1, 40, 43 dhe 49 të LPP-së.

Përveç kësaj, gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerësoi se nuk është e domosdoshme të caktohet seancën gjyqësore për ta kuptuar plotësisht validitetin e Prapësimit, siç ka caktuar neni 73 para. 1 i LPP-së, meqë nga shkresat e lëndës gjendja faktike dhe juridike ishte qartë

Gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta lidhur me këtë procedurë në gjykatë sipas prapësimit të Debitorit, pasi për gjykatën kërkesa e Kreditorit për shpërblimin e shpenzimeve procedurale është e pabazuar, meqenëse ajo nuk ishin të specifikuar siç kërkon neni 463 para. 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, gjegjësisht nuk e ka cekur shumën e saktë të shpenzimit.

Për këto arsye, në kuptim të nenit 73 para. 3 të LPP-së lidhur me nenin 13 para.1 nën para. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.598/2023
Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese ndaj këtij aktvendimi brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.